URDHËR
Nr.322, datë 9.8.2011

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të nenit 27 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", (të ndryshuar), si dhe të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave "Për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri",

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, të lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë Ministrinë.

2. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, sipas pikës 1 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga ligji nr.8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë" (të ndryshuar), në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr.1 të këtij urdhri.

4. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse deri në miratimin e këtij urdhri të ri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrave nr.642, datë 25.9.2009 dhe nr.50, datë 11.3.2011 "Për delegim kompetence", do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

5. Për autorizimet e lëshuara sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të gjejë zbatim ky i fundit.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike për zbatimin e këtij urdhri.

7. Çdo urdhër që bie ndesh me këtë urdhër shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani